



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201600316/2

Tiranë ___/___/2016

Lënda: Rekomandohet "Fillimi i hetimit për veprën penale "Kryerja e veprimeve arbitrare" ndaj punonjësve të Komisarjatisë të Policisë nr.1 Tiranë, për ushtrim dhune fizike të kryer në bashkëpunim, ndaj qytetarëve që protestonin tek kodrat e liqenit artificial më datë 21 Shkurt 2016, parashikuar nga neni 250 e 25 të Kodit Penal".

Drejtuar : Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor
Z.Petrit FUSHA

TIRANË

Për dijeni: Prokurorit të Përgjithshëm
Z.Adriatik LLALLA

TIRANË

I nderuar Z. FUSHA,

Avokati i Popullit ka filluar me inisiativë rastin e bërë publik në media për dhunën e ushtruar nga punonjësit e policisë së Komisarjatisë nr.1 Tiranë, ndaj qytetarëve të cilët po protestonin tek kodrat e liqenit artificial Tiranë, datë 21 Shkurt 2016, me qëllim që Bashkia të mos ndërtojë këndin e lojrave për fëmijë.

Mbi këtë shqetësim është urdhëruar kryerja e një hetim të pavarur administrativ, në vijim të së cilit janë kryer një sërë veprimesh të cilat kanë konsistuar në marrjen e shpjegimeve të qytetarëve M. B., A. A., F. B., dhe O. Zani., administrimit të fletëve të regjistrimit të evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar në Komisarjatin e Policisë nr.1 Tiranë datë 21 Shkurt 2016, dhe foto të ndryshme nga zhvillimi i protestës.

Rrethanat e ngjarjes

Më datë 21.02.2016, rreth orës 11.30 pjestarë të shoqërisë civile dhe qytetarë të Tiranës, kanë organizuar një protestë tek kodrat e liqenit artificial, për të moslejuar ndërtimin e një këndi lojrash për fëmijë nga Bashkia e qytetit. Pasi protestuesit kanë hequr ristelat prej druri që rrethonin vëndin ku do të kryheshin punimet, punonjësit e policisë kanë ushtruar dhunë fizike duke u përleshur me qytetarët.

Baza për fillimin e procedimit penal

Në deklaratimet e saj shtetasja M. B., ndërmjet të tjerave ka shpjeguar se: *“...Në këtë çast pashë një polic i cili kishte kapur në pjesën e lartë trupore një djalë të ri, të cilin po e dhunonte, gjë e cila më bëri të reagoj duke u futur për t'i ndarë që të stopohej dhuna ndaj këtij djali. Njëkohësisht i jam drejtuar gjatë gjithë kësaj kohe policisë me të njëjtat fjalë “Ndalni dhunën”...u mundova të tërheq vëmëndjen e policisë përmes thirrjes time dhe lëvizjes së duarve, kryesisht të dorës së djathtë që pa dashje preka strehën e kapeles të policit...por, paprimtas mbaj mend se mora një goditje të fortë në pjesën e djathtë të fytyrës e cila më ndikoi menjëherë duke më krijuar një gjëndje shoku, i pasuar me një dhimbje të menjëhershme në veshin e djathtë. Papritur ndjeva një shtrëngim të fortë në pjesën e prapme të qafës e cila pasoi me kapjen me të dyja duart nga i njëjti polic...”*

Shtetasi O. Z., në shpjegimet e tij sqaron se: *“...Unë po përpiqesha të mbroja shokun tim K. L., prej dhunës së ushtruar nga Policia, ndërkohë që dy ose më shumë policë më kapin duke më mbërthyer duart nga prapa dhe tërhequr për tek fugoni i policisë. Nga kapja me forcë e policëve unë pësova lëndime në pjesët e brëndshme të kyçeve të duarve”*.

Ndërsa shtetasi A. A., shpjegon se, në ditën e ngjarjes ka qënë rastësisht dhe kur ka parë protestuesit me aparatën e tij celular po bënte foto e video. *“Në ato momente i është afruar një punonjës policie i cili i ka përdredhur dorën duke dashur të marrë aparatën celular dhe duke i thënë që të fshinte videon. Më pas kanë ardhur dhe tre policë të tjerë të cilët me forcë e kanë marrë dhe futur tek një makinë policie duke e shoqëruar në Komisariatin e Policisë nr.1 Tiranë”*.

Mendime dhe përfundime

Duke analizuar në tërësi ngjarjen me provat e administruara rezultoi se:

Veprimet e kryera nga punonjësit e policisë të Komisariatit nr.1 Tiranë, janë të paligjshme dhe bien ndesh me dispozitat përkatëse ligjore dhe akteve nënligjore të cilat normojnë veprimtarinë e punonjësve të Policisë së Shtetit dhe konkretisht:

Nenin 105 të V.K.M-së nr.750 datë 16.09.2015 “Për miratimin e Rregullores së Policisë të Shtetit” ku thuhet: *“Etika e Policisë së Shtetit përmban parimet dhe*

normat që rregullojnë raportet e sjelljes, qëndrimin, plotësimin të detyrave dhe komunikimin të punonjësit të Policisë për të vepruar në përputhje me ligjin, me standartet më të larta profesionale në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe në respektim të dinjitetit njerëzor të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut”.

Nenin 133 pika 1 të ligjit “Për Policinë e Shtetit” ku thuhet: *“Punonjësi i Policisë përdor forcën për të përmbushur detyrën vetëm kur kjo është e nevojshme dhe vetëm nëse të gjitha masat e tjera janë të pasuksesshme apo të pamundura”.* Me këto veprime punonjësit e policisë janë përgjegjës sipas nenit 211 të “Rregullores së Policisë së Shtetit”, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.750 datë 16.09.2015, ku thuhet: *“Punonjësi është përgjegjës për përdorim të paligjshëm dhe të paarsyeshëm të forcës, nëse: 1.Përdor forcën në intesitet dhe kohë, mbi masën që është e domosdoshme për të arritur objektivin legjitim dhe të ligjshëm të Policisë”.*

Këto veprime bien ndesh me Misionin e Policisë së Shtetit, që është ruajtja e rendit dhe sigurisë publike në përputhje me ligjin dhe duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut, parashikuar në nenin 2 të ligjit nr.108/201, “Për Policinë e Shtetit”.

Shteti i ka dhënë Policisë përgjegjësi për kryerjen e shërbimeve të policimit në respekt të shtetit ligjor. Prandaj dhe shërbimet policore duhet t'i përshtaten parimeve të demokracisë, zbatimit të ligjit dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

Konstatohet se punonjësit e policisë kanë ushtruar dhunë fizike ndaj qytetarëve protestues, në tejkallim të kompetencave gjatë ushtrimit të detyrës duke cënuar lirinë e shtetasve, dhe për rrjedhojë ka dyshime të arsyeshme e të bazuara se ata kanë kryer veprën penale “Kryerja e veprimeve arbitrare”, në bashkëpunim. Objekti i veprës penale të mësipërme është marrëdhënia juridike e vendosur për të rregulluar veprimtarinë e rregullt shtetërore ose shërbimin publik që kanë të bëjë me respektimin e lirive të shtetasve, të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale.

Komisariati i Policisë nr.1 Tiranë, pas kryerjes së disa veprimeve hetimore procedurale, më datë 24.02.2016, me shkresën nr.1234/1, i ka përcjellë ato Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprat penale *“Shkatërrim prone”, “Organizim dhe pjesëmarrje në grumbullime dhe manifestime të paligjshme”* dhe *“Kundërshtim i punonjësit të policisë të rendit publik”*, parashikuar nga nenet 150, 236 dhe 262 të Kodit Penal.

Për zhvillimin e një hetimi të gjithanshëm dhe objektiv, do të sugjeronimin që organi procedues duhet të kryejë dhe veprime të tjera hetimore për ushtrimin e dhunës fizike të punonjësve të policisë dhe konkretisht:

- a. Identifikimin e punonjësve të policisë të Komisarariatit nr.1 apo dhe Drejtorisë së Policisë Tiranë, të cilët kanë ushtruar dhunë fizike ndaj qytetarëve, si M. B., E. T., ky i fundit mbante megafonin duke u bërë thirrje protestuesve, etj.
- b. Marrjen dhe administrimin si provë materiale të CD-ve me pamje nga protesta e qytetarëve datë 21 Shkurt 2016.
- c. Administrimin e akteve të ekspertimit mjeko ligjor për katër nga protestuesit, për të cilat nga Policia Gjyqësore e K.P.Nr.1 Tiranë , më datë 21.02.2016, janë përpiluar vendimet për kryerjen e ekspertimit.

Për sa sipër dhe bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë ku thuhet: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të drejtave të njeriut nga administrata publike”* dhe në bazë të nenit 21 gërma “ç” të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit” me ndryshimet përkatëse ku thuhet: *“Avokati i Popullit pas përfundimit të hetimit, i rekomandon Prokurorisë të fillojë hetimet në qoftë se vëren se është konsumuar figura e një vepre penale, ose të rifillojë hetimet e pushuara ose të pezulluara”*.

REKOMANDOHET

“Fillimi i hetimit, për veprën penale *“Kryerja e veprimeve arbitrare”*, ndaj punonjësve të Komisarariatit të Policisë nr.1 Tiranë, për ushtrim dhune fizike të kryer në bashkëpunim, ndaj qytetarëve që protestonin në kodrat e liqenit artificial më datë 21 Shkurt 2016, parashikuar nga neni 250 e 25 të Kodit Penal.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij Rekomandimi, lutemi na njoftoni brënda afatit ligjor prej 30 ditë, e parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Bashkëlidhur ju dërgojmë fotokopje të dokumenteve të mëposhtme:

1. Artikulli i gazetës “Shekulli” datë 22 Shkurt 2016.
2. Proces verbal i marrjes së deklarimeve të shtetases M.B., datë 21.02.2016.
3. Proces verbal i marrjes së deklarimeve të shtetasit A.A., datë 21.02.2016.
4. Proces verbal i marrjes së deklarimeve të shtetasit F. B., datë 22.02.2016.
5. Proces verbal i marrjes së deklarimeve të shtetasit O. Z., datë 22 Shkurt 2016.
6. Kopje e shkresës nr.1234/1 datë 24.02.2016, e K.P.nr.1 Tiranë, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
7. Foto të zhvillimit të protestës të qytetarëve datë 21.02.2016, tek kodrat e liqenit artificial Tiranë.

Duke besuar në mirëkuptimin Tuaj.

Konc.&Dakt.P.A.
Kom.A.SH
Tiranë më 01.03.2016

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI

